



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



Nr. 02-060/03-28762 dt. 15.06 2023

Në bazë të nenit 52 të Ligjit nr. 03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 12 pika 12.2 dhe nenit 21 pika 21.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës të Drenasit z.Milaim Hajdari, me dt. **22.06.2023** (e enjte) duke filluar në ora 10:00, në sallën e Bordit të Komunës.

THËRRET
Mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa

Mbledhja do të këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur më dt. 19.05.2023.
2. Korniza afatmesme buxhetore 2024-2026, lista e projekteve kapitale 2024-2026 dhe buxhetimi i përgjegjshëm gjinor.
3. Propozim vendim për miratimin e planit rregullues të hollësishëm për qendrën e qytetit-Gllgoc.
4. Propozim vendim për financimin e projektit nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie sociale.
5. Propozim vendim për miratimin e kërkesës, Nr.01-070/01-26071, dt.1.6.2023 për ndihmë financiare për mjekim urgjent të sëmundjes-kancer, në shumën totale prej 3,000.00 euro.
6. Propozim vendim për miratimin e kërkesës, Nr.01-070/01-28069, dt.13.6.2023 për ndihmë financiare për mjekim urgjent të sëmundjes OU Nicrophthalma, në shumën totale prej 3,000.00 euro
7. Të ndryshme.

Drenas, 15.06.2023



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Milaim Hajdari



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



Nr. 02 060-26299 dt. 02 06 2023

PROCESVERBALI

I mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtur më dt. **19.05.2023**, ora 10:00.

Mbledhjen e kryesoi: Milaim Hajdari- Kryesues

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa ku të pranishëm ishin: Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, Kryesuesi i Kuvendit Milaim Hajdari, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Hamit Kastrati (PDK), Malsore Cakiqi (PDK), Azemine Bujupi Gjoka (DD), Hamit Haxhiu (DD), Arbër Halilaj (GREEN), Florentina Elezi-Veliu (VV) si dhe Drejtor të Drejtorive Komunale.

Komiteti filloi punimet më këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur më dt. 13.04.2023.
2. Propozim vendim për miratimin e Planit Rregullues të Hollsishëm për Qendren e Qytetit –Drenas/Gllogoc.
3. Propozim vendim për kompensimin e anëtarëve të Komisionit për zgjedhjen e kryetarëve dhe këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.
4. Propozim vendim për Rialokim të mjeteve financiare në Shërbimet e Shëndetësisë.
5. Propozim vendim për rritjen dhe bartjen e të hyrave Vetanake.
6. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- pasi përshëndeti të pranishmit, deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa, ku prezantoi rendin e ditës, theksoi se kemi edhe dy pika shtesë për rend dite: 1. Propozim vendim për rialokim të mjeteve financiare nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
2. Propozim vendim për shfuqizimin e vendimit 02 Nr.400/01-14929 të datës 28.03.2023, të Kuvendit të Komunës së Drenasit.

Florentina Elezi-Veliu, meqenëse tani është 1 Qershori “Dita e Fëmijëve” kemi mëndu me bë diçka bashkërisht për fëmijët duke marrë parasysh që edhe edukimi i hershem është shumë i rëndësishëm, por çerdhet publike janë në mungesë në Komunën e Drenasit, e kemi vetëm një çerdhe publike një në Drenas dhe një në Komoran, çerdhet private është vetëm një numër i caktuar që i ndjekin, kështu që kërkoj me e bërë një subvencionim për fëmijët që shkojnë në kopshtet private komuna me ia pagu prej 30% ndërsa prindërit 70% në këtë mënyrë ia lehtësojmë edhe prindërve dhe të bëjmë diçka të mirë për fëmijët. Gjithashtu kam kërkuar të dhëna se sa fëmijë i ndjekin kopshtet private në Drenas sepse nuk është një numër i saktë, e që fatkeqësisht edhe është problem i madh edhe për Ministrinë, për Drenas për vitin 2022/2023 figuron vetëm 80 fëmijë që i ndjekin kopshtet private e ky numër nuk është real, kërkoj nga asambleja me e përkrah këtë iniciativë. Kërkoj nga Drejtoria e Arsimit të dhëna për numrin e saktë të fëmijëve që ndjekin kopshtet private në komunën tonë.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladorvci, kur bëni propozime dhe kur ka të bëjë më implikime buxhetore duhet me u konsultu se pari me ne, nuk kemi të drejt me ia pagu askujt çerdhet private për fëmijë, ne kemi pas një takim me ministrinë i kemi diskutuar këto çështje dhe gjitha komunat e kanë ngrit shqetësimin e mungesës të çerdheve njëkohësisht e mungesës se personelit ose pagesës se personelit sepse çerdhe mundemi me ndërtua pa asnjë problem mirëpo mjete për staf ne nuk kemi, ata e kanë marrë si rekomandim, ne nuk kemi të drejt me pagu çerdhe private.

Florentina Elezi-Veliu, mundeni me pagu jo me pagu individin mirëpo ka baza ligjore që mundesh kopshtin direkt me pagu që prindi me pagu vetëm pjesën tjetër derisa mundemi me i subvencionua klubet sportive mundeni edhe këtë, kërkoj që me hy ne rend dite pastaj kuvendi vendos a me e votu apo jo.

Shyqiri Bublaku-Drejtor i Financave, sa i përket financimit gjegjësisht subvencionimit të çerdheve private nuk mundemi me ligj me i subvencionu, ne nuk guxojmë as në projekte kapitale me investu në toka private duhet vetëm pronë shoqërore me qenë ose objekt apo firmë publike, rastin konkret ne mundemi vetëm çerdhet publike me financu.

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim rendin e ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 06 vota “Për”, kundër nuk pati, 1 abstenim, u miratua rendi i ditës, bashkë me dy pikat shtesë të cekura më lartë.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: **1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur me dt. 13.04.2023.**

Nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 07 vota “Për”, kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës: **2. Propozim vendim për miratimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Qendrën e Qytetit –Drenas/Gllogoc.**

Flutura Avdiu-Drejtoreshë e Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, Propozim vendim për miratimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Qendrën e Qytetit – Drenas/Gllogoc, e cila përfshin një sipërfaqe prej 110 Ha, me miratimin e hartës zonale për periudhën 2022-2023 është përcaktuar dhe është kërkuar që të identifikohet zona për të cilat kërkohet për me u miratua plani rregullues i hollësishëm, ne kemi kontraktuar një kompani hartuese dhe me dt. 31 gusht 2022 kemi filluar me vendim të kuvendit të komunës për hartimin e planit rregullues të hollësishëm për qendrën e qytetit për t'i përcaktuar kushtet për rregullimin e hartimit e hapësirave për zonën urbane, këtë vit kemi filluar me planin rregullues për qendër të qytetit dhe besoj që në gjashtë mujorin e dytë do të fillohet sipas kontratës pjesën e Komoranit si dhe lagjen tek "Feronikeli" po ashtu me vendimin e kuvendit pasi e kemi miratuar vendimin për lënien në shqyrtim të projekt dokumentit të planit rregullues të hollësishëm edhe për 30 ditë e kemi lënë në dispozicion qytetareve, agjencive, departamenteve dhe organeve të tjera për shqyrtim dhe komente për këtë projekt dokument, pas shqyrtimit publik 30 ditë sipas procedurave të përcaktuara me ligj kemi inkorporuar komentet, ku kemi pranuar gjithsej 14 komente dhe sipas përfundimit të kësaj është bërë një raport ku do t'i dorëzohet kuvendit të komunës për shqyrtim dhe miratim përfundimtar se bashku me draft pasi që kompania është duke punuar ende pjesën hartografike për t'i inkorporuar komentet, materialin shtese do te ua përcjelli për mbledhje të kuvendit.

Arbër Halilaj, duke pas për bazë Planin Rregullues të Hollësishëm për Qendrën e Qytetit – Drenas/Gllogoc, unë kisha kërkuar që pas gjithë këtij procesi të lenë në diskutim publik 30 ditë dhe procedurat tjera që janë përmbush dhe duke pa rëndësinë e tij paraprakisht kërkoj informacion shtesë, një raport të detajuar, cilat kanë qenë vërejtjet dhe sugjerimet e qytetareve, çka ofron ky plan, sa janë inkorporuar ankesat dhe kërkesat e qytetareve në këtë plan para se ne ta kemi në asamble për votim, kërkoj një informacion shtesë për këtë pikë të rendit të ditës?

Nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 05 vota "Për", 1 kundër, 1 abstenim.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës: **3. Propozim vendim për kompensimin e anëtarëve të Komisionit për zgjedhjen e kryetarëve dhe këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.**

Florentina Elezi-Veliu, e di rëndësinë e komisioneve dhe e di punën e madhe që e bëjnë komisionet dhe shpeshherë ndeshemi me situata jo të këndshme, unë jam kundër këtij propozim vendimi për arsye se nëse i numërojmë jen 25 vendbanime që kane me u zgjedh kryetaret e fshatrave, dhe shuma prej 50 euro që i bien 1250 euro për dy muaj, 1250 euro një për anëtar këtu janë 7 anëtar e qe i bien afër 10 mijë euro, e për çka me i marrë afër 10 mijë euro derisa asamblistët e kanë një pagë që me atë page përfshihet edhe në komisione, dhe ky është mandati i tretë dhe asnjëherë asnjë komision nuk është paguar deri më tani përkundër pagave që kane qenë shumë të vogla, dhe kryetaret e fshatrave deri më tani nuk janë paguar asnjëherë për gjithë punën e tyre që e kanë bërë për krejt vitin. Mendoj që shuma prej 50 euro është e papranueshme prej secilit prej nesh.

Arbër Halilaj, duke u ndërlidh me diskutimin e Florentinës mendoj që puna në komisione dhe angazhime përveç angazhimit në asamble janë obligim dhe përgjegjësi dhe privilegj, duk e konsideruar si një shumë të madhe, të shkojmë me një shumë të caktuar për krejt këtë angazhim 250-300 euro mirëpo jo me tepër.

Azemine Bujupi, pajtohem me parafolësit është një shumë tepër e madhe, është një shumë e papranueshme.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, këta e kanë për tërë muajin kërkesën për 50 € dalin çdo fshat, janë jashtë orarit të punës, kjo është punë që duhet me u pagu,

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari bashkë me Anëtarët e KPF-se lidhur me propozimin në fjalë rekomanduan zyrës së kryetarit që të ndryshohet Propozim vendimi neni II, ku thotë: anëtarët e komisionit do të kompensohen për punën e kryer me shumë prej 50 euro për çdo ditë pune, ndërsa KPF-ja propozoi që për secilin anëtar pagesa të jetë për gjithë punën e kryer vetëm 300 euro.

Pas sugjerimeve që u dhanë kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 06 vota “Për”, kundër nuk pati, abstenim nuk pati. Hamit Haxhiu nuk mori pjesë në votim.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e katërt të rendit të ditës: **4. Propozim vendim për Rialokim të mjeteve financiare në Shërbimet e Shëndetësisë.**

Lumnije Krapi- Drejtoreshë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies sociale, duke e konsideruar të arsyeshme dhe shumë të nevojshme veturat e ndihmës se shpejt në QKMF që janë vjetruar dhe jo funksionale dhe marrë parasysh që planifikimi bëhet edhe për zgjerimin e AMF-së në Arllat dhe ende nuk ka kaluar rregullorja për sistematizimin e vendeve të punës kemi me i kalu edhe disa hapa deri në përfundim të kësaj rregulloreje, në momentin që kalon rregullorja ky projekt zgjerimi i QKMF-së nëDrenas dhe kemi kërkuar që të blejmë edhe një ambulancë të re, kërkoj mbështetjen tuaj.

Pas sqarimit kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 07 vota “Për”, kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u rekomandua për kuvend kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës: **5. Propozim vendim për rritjen dhe bartjen e të hyrave Vetanake.**

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 02 vota “Për”, 1 kundër, 1 abstenim, 4 vota kundër.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës: **6. Propozim vendim për rialokim të mjeteve financiare nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.**

Enkela Dema- Drejtoreshë për Kulturë, Rini dhe Sport, Propozohet rialokimi i mjeteve financiare brenda nënprogramit Shërbimet Kulturore (85001)dhe kategorisë së Shpenzimeve

Kapitale (30) në shumën 300,000.00 euro, herën e kaluar kur ka kalu ky propozim vendim kemi bërë disa gabime në kodet buxhetore kur e kemi përcjell për MAPL dhe është kthyer nga MAPL-ja më një rekomandim ku u kërku me u specifikua saktë burimet e financimit dhe në këtë rast ne e kemi përbërë përputhjen me rekomandimin e Ministrisë së Financave, shfuqizohet vendimi i kaluar që e kemi pas dhe me marrë vendimin e ri.

Pas sqarimit kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 05 vota “Për”, kundër nuk pati, 2 abstenim, u rekomandua për kuvend kjo pikë e rendit të ditës.

Azmine Gjoka, a është specifikua saktë se ku keni me i bart këto mjete?

Shyqiri Bublaku-Drejtori i Financave, po është specifikua prej objektit multifunksional është kërkuar edhe në propozimin e vitit kaluar më kalu në ndërtimin e stadionit fazën e dytë, edhe këtu është e njëjta.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, shpeshherë ministria shfuqizon vendimet dhe na kërkon rishqyrtim të vendimit, dmth një ndryshim i vogël teknik apo ligjor, në këtë rast kanë kërkuar më i specifikua kodet dhe ashtu siç e kanë kërkuar dhe e kemi sjellë propozimin.

Pas sqarimit kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 06 vota “Për”, 1 kundër, 1 abstenim, u rekomandua për kuvend kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e shtatë të rendit të ditës: **7. Propozim vendim për shfuqizimin e vendimit 02 Nr.400/01-14929 të datës 28.03.2023, të Kuvendit të Komunës së Drenasit.**

Azmine Gjoka, a ke kjo për ngrohtoren e qytetit të Drenasit, gjithë ato leksione që ishin herën e kaluar si mbetet?

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, ekipa e qeverisë dhe e GIZ-it që janë duke e bërë fizibilitetin na e ka propozu pronën e feronikelit sepse është interes që ata e vlersojnë, prona është në hipotekë, ata e kanë cek që prona lirohet në muajt në vazhdim dhe lirohet prej hipotekës, ata na kanë propozua që me e sjellë në kuvend, na jemi të detyruar me e tërheq, dhe me iu thënë atyre a keni ndonjë propozim tjetër apo duhet të presim edhe 3-4 muaj deri të lirohet, ne vetëm kemi dashtë me ia lehtësu procedurat atyre.

Pas sqarimit kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 07 vota “Për”, kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u rekomandua për kuvend kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e tetë rendit të ditës: **8. Të ndryshme.**

Hamit Haxhiu, kërkoj që rregullohet urgjent trotuari rrugës për në shkollë të mesme, sepse nxënësit po kanë shumë vështirësi të kalojnë anej sepse është një hapësirë shumë e vogël.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, unë kam qenë takim me zv.Ministrinë e Infrastrukturës dhe e kemi diskutuar për punën e projektit për rrugën 4 korsi dhe shumë


shpejt do të dalin me punime dhe ne do ta rregullojmë atë pjese dhe do të shtrojmë edhe trotuar deri sa të fillojnë me punimet e rrugës, pra ka me pas vetëm dalje jo hyrje.

Azmine Gjoka, po ka shumë probleme në rrugë psh Komoran-Drenas, dhe rrugën tek Feronikeli kush mundet me ndërhy për me rregullu se paku gropat e mëdha?

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, rrugën regjionale prej Komoranit e deri në Skenderaj e ka për obligim Ministria, na kanë thënë që jemi duke i kry procedurat e tenderimeve, dhe pa i kry procedurat e tenderëve nuk mundemi me bë asnjë zgjidhje.


Pasi nuk pati diskutime të tjera kryesuesi e konsideroj të mbyllur mbledhjen, mbledhja përfundoj rreth orës 10:55 min .

Procesmbajtëse:


Liridona Fejza-Ajazi



Kryesuesi i Kuvendit Komunal


Milaim Hajdari



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Glllogocit
Zyra e Kryetarit



01-Nr. 030/01-23130 dt. 13/06/2023

Në bazë të nenit 58 pika (h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 72 paragrafi 1 pika (h) të Statutit të Komunës së Glllogocit, në bazë të nenit 5 nënparagrafi 1.2 pika 1.2.3, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.3, nenit 17 të Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, Udhëzimit Administrativ MMPH Nr.01/2018 për Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Planeve Rregulluese të Hollësishme, Udhëzimit Administrativ MMPH Nr.08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor. Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës, të miratoj këtë:

PROPOZIM VENDIM
PËR MIRATIMIN E PLANIT RREGULLUES TË HOLLËSISHËM PËR QENDRËN E
QYTETIT-GLLOGOC

Neni 1

Miratohet vendimi i Planit Rregullues të Hollësishëm për Qendrën e Qytetit-Glllogoc.

Neni 2

Planet Rregulluese të Hollësishme përcaktojnë kushtet për rregullimin e hapësirave për zona urbane apo rurale, siç është përcaktuar në Planin Zhvillimor Komunal dhe Hartën Zonale Komunale.

Neni 3

Zona për të cilën do të hartohet Plani Rregullues i Hollësishëm është Qendra e Qytetit- Glllogoc dhe përfshinë një sipërfaqe prej S=110.00 Ha.

Neni 4

Plani Rregullues i Hollësishëm mbulon një periudhë së paku tetë (8) vjeçare.

RL

Neni 5

Autoriteti për planifikim hapësinor është përgjegjës për zbatimin e Planit Rregullues të Hollësishëm në bashkërendim dhe bashkëpunim me autoritetet tjera përkatëse sektoriale përgjegjëse.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi pas aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Glllogocit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së.


Kryetari i Komunës
Ramiz Lladrovci

ARSYETIM

Me miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Glllogocit për periudhën 2022-2030 të datës 24.06.2022, Komuna e Glllogocit është përcaktuar që përmes Hartës Zonale të Komunës të identifikojë zonat për të cilën kërkohet të hartohet Plani Rregullues i Hollësishëm, me vendim të kuvendit të komunës 02-Nr.030/01-46344 datë 31.08.2022, është filluar me hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Qendrën e Qytetit- Glllogoc për të përcaktuar kushtet për rregullimin e hapësirave për zonën urbane.

Me Vendimin 02-Nr.400/01-14932 datë 28.03.2023 të kuvendit të komunës, është miratuar vendimi për lënie në shqyrtim publik të projekt dokumentit të Planit Rregullues të Hollësishëm për Qendrën e Qytetit- Glllogoc, në mënyrë që t'u lihet në dispozicion qytetarëve, agjencive, departamenteve dhe organeve të tjera për shqyrtim dhe komente për projekt dokumentin Plani Rregullues i Hollësishëm për Qendrën e Qytetit- Glllogoc.

Shqyrtimi publik i Projekt dokumentit të Planit Rregullues të Hollësishëm për Qendrën e Qytetit- Glllogoc ka zgjat 30 ditë, sipas procedurave të përcaktuara me ligj. Pas përfundimit të kohëzgjatjes së shqyrtimit publik, projekt dokumenti së bashku me përmbledhje të shkurtër të komenteve të bëra gjatë diskutimit publik- raportin, do t'i dorëzohen kuvendit të komunës për shqyrtim dhe miratim përfundimtar.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Gllogocit
Zyra e Kryetarit



01- Nr 400-28321 dt. 14.06 2023

Në veshtrim të nenit 58, paragrafi 1, nën-paragrafi h të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, nenit 34, pika 6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Rregullores 12 Nr. 320-19332 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, Rregullores MF-NR 04/2017 mbi Kritret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, dhe Rregulloren 02-400/01-18380 për Ndryshim dhe Plotësim të Rregullores për Ndarjen e subvencioneve, vendimit 01 Nr.400/01-2789, të dt. 12.06.2023, si dhe buxhetit të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Drenasit për vitin 2023, me propozim të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale, Kryetari i Komunës paraqet këtë:

PROPOZIM VENDIM
PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT

Neni 1

Me këtë propozim vendim, kërkohet mbështetja financiare për projektin “Shërbime të avancuara rehabilituese dhe trajtim gjithëpërfshirës social për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara”, të Shoqatës së Personave me Aftësi të Kufizuara “Handikos”, lidhur me mbulimin e shpenzimeve për zhvillimin e aktiviteteve për vitin 2023.

Neni 2

Projekti i Shoqatës së Personave me Aftësi të Kufizuara “HANDIKOS”- “Shërbime të avancuara rehabilituese dhe trajtim gjithëpërfshirës social për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara”, përkrahet në shumën prej 5.000 € (pesë mijë euro), mjete të cilat do të shfrytëzohen për mbulimin e shpenzimeve për vitin 2023.

Neni 3

Financimi- Subvencionimi i projektit do të bëhet nga kategoria ekonomike e shpenzimeve subvencione dhe transfere/ kodit ekonomik 21/611/73010/21200/0760 të parapara me Buxhetin për vitin 2023 të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale.

Neni 4

Mjetet financiare barten në konton e Shoqatës së Personave me Aftësi të Kufizuara “HANDIKOS”, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale është e obliguar që për shumën e mjeteve për financimin e përmendur në nenin 2 të këtij propozimvendimi të përcjellë implementimin e projektit, duke kërkuar nga OJQ “HANDIKOS”, që të bëjë raport narrativ-me shkrim dhe financiar përmes zyrtarit monitorues në mënyrë që të njoftojë DSHMS-në për mënyrën e shpenzimit të mjeteve.

Neni 5

Ky propozim vendim hynë në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit Komunal të Drenasit dhe vlerësimi të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së, për zbatimin e tij do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale.



KRYETARI I KOMUNËS

Ramiz Lladrovci
Ramiz Lladrovci

Arsyetimi

Bazuar në nenin 16 paragrafi 3, të Rregullorës MF-NR. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, Rregullores Nr. 12/320-19338, të dt. 07.04.2017 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, është formuar komisioni me Vendimin Nr. 01-020/04-24052 e dt. 22.05.2023, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve përmes thirrjes publike Nr.06-400/01-22083, të dt. 10.05.2023, të shpallur nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale për vitin 2023.

Komisioni ka shqyrtuar dhe vlerësuar aplikacionet e aplikantëve për subvencionim të OJQ-ve në bazë të thirrjes publike të lartëcekur, ku gjithsej kishin aplikuar dy (dy) OJQ: “HANDIKOS” dhe “BLIRI” .

Pas hapjes së zarfeve të OJQ-ve aplikuese, komisioni ka verifikuar dokumentacionet e dorëzuara të dy organizatave aplikuese, të cilat vazhdojnë të jenë funksionale, mirëpo OJQ “Bliri” nuk i ka përmbushur kriteret e thirrjes publike dhe si rrjedhojë komisioni me vendim përcakton si aplikant i kualifikuar për mbështetje financiare Shoqatën e Përsoneve me Aftësi të Kufizuara “HANDIKOS” Drenas.

Meqë vlera e përkrahjes financiare në bazë të thirrjes publike është 5.000 €, kjo shumë do t'i ndahet kësaj OJQ-je, financimi- subvencionimi i projektit do të bëhet nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere/ kodi ekonomik 21/611/73010/21200/0760 të paraparë me Buxhetin për vitin 2023 të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



01 Nr. 400/01-28513 dt. 15.06.2023

Në vështrim të nenit 58, paragrafi 1, nën paragrafi h të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon që në bazë të nenit 12 paragrafi 12.1 , 12.2 pika d) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Rregulloren për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Nr. 12-320-19338 dt. 07.04.2017, Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për ndarjen e subvencioneve Nr.400/01-18380 e datës 27.4.2022, si dhe Kërkesës të palës, Nr. 01-070/01-0023340/23, dt. 17.5.2023, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë 26.5.2023, të aprovojë këtë:

POPOZIMVENDIM

Për miratimin e Kërkesës, Nr. 01-070/01-26071, dt. 1.6.2023, për ndihmë financiare për mjekim urgjent të sëmundjes – kancer, në shumën totale prej 3,000.00 euro

Neni 1

Me këtë propozim vendim në përputhje me Rregulloren për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve Nr. 12-320-19338 dt. 07.04.2017 si dhe rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për ndarjen e subvencioneve Nr.400/01-18380 e datës 27.04.2022, propozohet miratimi i Kërkesës Nr. 01-070/01-0023340/23, dt. 17.5.2023, për ndihmë financiare për mjekim urgjent të sëmundjes – kancer, në shumën totale prej 3,000.00 euro.

Neni 2

Mjetet financiare të aprovuara sipas këtij Propozim Vendimi do të paguhen nga pozicioni, kategoria ekonomike subvencione dhe transfere/kodi ekonomik 21/611/73010/21200/00000/0760, të parapara me buxhetin e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Buxhetin për vitin 2023, ndërsa transferi do të bëhet përmes xhirollogarisë në emër të **Milaim Bazaj, NLB, nr. i kontos: XK05 17-01-0186045108.77.**

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale –DSHMS si dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa

Neni 4

Ky propozim vendim hyn në fuqi pas aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Drenasit .



Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci

ARSYETIM

Me datë 1.6.2023, pranë Zyrës së Kryetarit është adresuar kërkesa me numër Nr. 01-070/01-26071, dt. 1.6.2023, përmes së cilës pala Milaim Bazaj, ka adresuar nevojën e tij për mbështetje financiare për trajtimin urgjent mjekësor të motrës së tij, Nazmije Bazaj, me kancer, sëmundje të cilën e ka dëshmuar edhe me dokumente mjekësore. Komuna e Drenasit brenda kompetencave të saja ligjore dhe buxhetore, e ka të rregulluar këtë çështje përmes Rregullores së brendshme komunale - Rregulloren për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve Nr. 12-320-19338 dt. 07.04.2017 si dhe rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për ndarjen e subvencioneve Nr.400/01-18380 e datës 27.04.2022 e cila parasheh se Komuna subvencionon në formë të përkrahjes financiare banorët rezidentë të Komunës së Drenasit për përballimin e shpenzimeve të shërimit nga sëmundjet e rënda, rehabilitimit, për rastet emergjente shëndetësore, për familjet që janë në gjendje të vështirë ekonomike dhe sociale sipas kriterëve të përcaktuara me të njëjtin dokument/rregullore, ku edhe duke u bazuar në këtë, përmes këtij dokumenti,

propozohet që në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe brenda kompetencave të veta, Kuvendi i Komunës të aprovojë kërkesën e qytetarit të komunës së Drenasit z. Milaim Bazaj për ndihmë financiare për mjekim urgjent të sëmundjes – kancer ovarian, në shumën totale prej 3,000.00 euro si rast i cili i plotëson kriteret për subvencionim emergjent për çështje shëndetësore dhe mirëqenie sociale dhe njëkohësisht si rast i cili kërkon veprim të menjëhershëm nga ana e jonë duke i mundësuar palës së lartëcekur vazhdimin e trajtimit të nevojshëm mjekësor për motrën e tij.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



01 Nr. 400/01-28510 dt. 15.06.2023

Në vështrim të nenit 58, paragrafi 1, nën paragrafi h të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon që në bazë të nenit 12 paragrafi 12.1 , 12.2 pika d) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Rregulloren për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Nr. 12-320-19338 dt. 07.04.2017, Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për ndarjen e subvencioneve Nr.400/01-18380 e datës 27.4.2022, si dhe Kërkesës të palës, Nr. 01-070/01-28069, dt. 13.6.2023, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë _____, të aprovojë këtë:

POPOZIMVENDIM

Për miratimin e Kërkesës, Nr. 01-070/01-28069, dt. 13.6.2023, për ndihmë financiare për mjekim urgjent të sëmundjes – OU Nicrophthalma, në shumën totale prej 3,000.00 euro

Neni 1

Me këtë propozim vendim në përputhje me Rregulloren për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve Nr. 12-320-19338 dt. 07.04.2017 si dhe rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për ndarjen e subvencioneve Nr.400/01-18380 e datës 27.04.2022, propozohet miratimi i Kërkesës Nr. 01-070/01-28069, dt. 13.6.2023, për ndihmë financiare për mjekim urgjent të sëmundjes – **OU Nicrophthalma**, në shumën totale prej 3,000.00 euro.

Neni 2

Mjetet financiare të aprovuara sipas këtij Propozim Vendimi do të paguhën nga pozicioni, kategoria ekonomike subvencione dhe transfere/kodi ekonomik 21/611/73010/21200/00000/0760, të parapara me buxhetin e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Buxhetin për vitin 2023, ndërsa transferi do të bëhet përmes xhironlogarisë në emër të **Bedri Bazaj, ID 1249036052, në Raifeisen Bank, nr. i kontos: 1501070002530610.**

Bedri Bazaj

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale –DSHMS si dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa

Neni 4

Ky propozim vendim hyn në fuqi pas aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Drenasit.


Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci

ARSYETIM

Me datë 13.6.2023, pranë Zyrës së Kryetarit është adresuar kërkesa me numër Nr. 01-070/01-28069, dt. 13.6.2023, përmes së cilës pala Bedri Bazaj, ka adresuar nevojën e tij për mbështetje financiare për trajtimin urgjent mjekësor të fëmijës së tij, Olta Bedri Bazaj, me sëmundjen **OU Nicrophthalma**, të cilën e ka dëshmuar edhe me dokumente mjekësore.

Komuna e Drenasit brenda kompetencave të saja ligjore dhe buxhetore, e ka të rregulluar këtë çështje përmes Rregullores së brendshme komunale - Rregulloren për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve Nr. 12-320-19338 dt. 07.04.2017 si dhe rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për ndarjen e subvencioneve Nr.400/01-18380 e datës 27.04.2022 e cila parasheh se Komuna subvencionon në formë të përkrahjes financiare banorët rezidentë të Komunës së Drenasit për përballimin e shpenzimeve të shërimit nga sëmundjet e rënda, rehabilitimit, për rastet emergjente shëndetësore, për familjet që janë në gjendje të vështirë ekonomike dhe sociale sipas kriterëve të përcaktuara me të njëjtin dokument/rregullore, ku edhe duke u bazuar në këtë, përmes këtij dokumenti,

proponohet që në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe brenda kompetencave të veta, Kuvendi i Komunës të aprovojë kërkesën e qytetarit të komunës së Drenasit z. Bedri Bazaj për ndihmë financiare për mjekim urgjent të sëmundjes – **OU Nicrophthalma**, në shumën totale prej 3,000.00 euro si rast i cili i plotëson kriteret për subvencionim emergjent për çështje shëndetësore dhe mirëqenie sociale dhe njëkohësisht si rast i cili kërkon veprim të menjëhershëm nga ana e jonë duke i mundësuar palës së lartëcekur vazhdimin e trajtimit të nevojshëm mjekësor për fëmijën e tij.